

VENDIM
Nr. 117, datë 15.7.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
CERTIFIKIMIN NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT”
SHA**

Në mbështetje të neneve 3, pika 8; neni 16; nenet 54 dhe 58, pikat 1, 3 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, si dhe neneve 6, 7, 8, 9, pika 1, nenet 10 dhe 12 të “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit”, miratuar me vendimin nr. 154, datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, neni 19, pika 1, germa “b”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi aplikimin e OST sh.a., për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike,

duke konsideruar që:

- Shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., me shkresën nr. 4179 prot., datë 13.7.2016, regjistruar në ERE me nr. 545 prot., datë 13.7.2016, ka paraqitur kërkesën për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, si Operator i Sistemit të Transmetimit (OST-E).

- Kjo kërkesë për miratim, mbështetet në sa përcaktuar në nenet 54 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s, nr. 154, datë 11.12.2015, si dhe pikës 4 të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”, e cila përcakton se: menjëherë mbas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, OST-ja aplikon në ERE për certifikim në bazë të nenit 58, të ligjit nr. 43/2015.

- Për efekt të këtij aplikimi nga OST sh.a., bashkë me kërkesën me shkrim për certifikim janë depozituar dokumentet e parashikuara në nenin 9 të “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 154, datë 11.12.2015.

- Të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacioni i kërkuar sipas nenit 9 të Rregullores janë paraqitur në ERE, në gjuhën shqipe dhe atë angleze, me shkrim dhe në mënyrë elektronike.

- ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, por mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit çdo informacion të nevojshëm për qëllim të certifikimit, referuar pikës 4, të nenit 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- ERE në cilësinë e autoritetit përgjegjës për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike dhe në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të detyrimeve sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, ka miratuar me vendimin nr. 154, datë 11.12.2015, “Rregullat për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike”.

- Neni 9 i vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, neni 58, pika 6, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon që ERE, duhet të vërë në dijeni Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për vendimin e shprehur apo të pashprehur me fjalë për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike të OST sh.a.

2. T'i përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për opinion ashtu si përcaktohet në nenin 58, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

3. T'i përcjellë këtë vendim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti